



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br.

95-98121

Data/Datum.

01.03.21

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

PRISHTINË - PRISTINA

PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.95/21

98/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik “DWH Kosova” SH.P.K-Prishtinë dhe OE “DWH Albania” SH.P.K.-Shqipëri, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ri-shpallje, Furnizim me pajisje të Instrumentit GPS dhe Total Station”, me nr. të prokurimit: 632-20-7318-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Gjakovë”, më datën: 25.02.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “DWH Kosova” SH.P.K-Prishtinë dhe OE “DWH Albania” SH.P.K.-Tiranë-Shqipëri, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ri-shpallje, Furnizim me pajisje të Instrumentit GPS dhe Total Station”, me nr. të prokurimit: 632-20-7318-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Gjakovë”.

II. OBLIOHET, AK të marrë për bazë sqarimet e dhëna në këtë ekspertizë gjatë ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-shpallje, Furnizim me pajisje të Instrumentit GPS dhe Total Station”, me nr. të prokurimit: 632-20-7318-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Gjakovë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “DWH Kosova” SH.P.K-Prishtinë dhe OE “DWH Albania” SH.P.K.-Shqipëri, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues “DWH Kosova” SH.P.K-Prishtinë dhe OE “DWH Albania” SH.P.K.-Shqipëri, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 01.02.2021 me nr. 95/21, dhe me datë 02.02/2021 me nr. 98/21, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ri-shpallje, Furnizim me pajisje të Instrumentit GPS dhe Total Station”, me nr. të prokurimit: 632-20-7318-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Gjakovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 2, 7 dhe nenin 28 të LPP-së, te ankesa me nr. 95/21.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 2, 7 dhe nenin 28 të LPP-së, te ankesa me nr. 98/21.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 04.02.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e data: 18.02.2021, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “DWH KOSOVA” Sh.P.K - PRISHTINË dhe “DWH ALBANIA” Sh.P.K – TIRANË

Sqarim hyrës: Fillimisht sqarojmë se pretendimet ankimor të paraqitura nga OE ankues kanë të bëjnë me dokumentet e tenderit, përkatësisht specifikimet teknike. OE ankues kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 25.01.2021 me pretendime të njëjta ankimore sikurse në këtë ankesë. AK me datë 28.01.2021 ka nxjerr vendim me të cilin refuzon kërkesën për rishqyrtim. Në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit më parë janë parashtruar tri ankesa nga OE ankues “DWH KOSOVA” Sh.P.K, e për të cilat Paneli Shqyrtues i OSHP-së ka vendosur sipas vendimeve me numër 458/20, 640/20 dhe 1021/20. Po ashtu OE ankues disa nga pretendimet ankimore të paraqitura në këtë ankesë sikurse janë formatet dhe autorizimi nuk i ka paraqitur si pretendime ankimore në të kaluarën përkundër që këto kërkesa janë vendosur që nga fillimi.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 1 : OE ankues pretendojnë se AK ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së duke mos vendosur kërkesa të mjaftueshme për GPS. AK në dosjen e tenderit, respektivisht në paramasë ka paraqitur

specifikimet teknike, ku ndër të tjera ka përcaktuar “Të përkrah të gjitha sistemet satelitore globale që janë në funksion: GPS, GLONASS, Galileo, Beidou (me të gjithë sinjalet përkatëse për çdo sistem satelitor që prodhuesi ofron) “. Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, përkatësisht Neni 28 përcakton “AK do t’i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. AK është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë OE”. Në lidhje me këtë pretendim sqarojmë se duke qenë që kërkesat nuk janë përjashtuese pretendimi ankimor është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 2 : OE ankues po ashtu pretendon se AK ka vendosur specifikime diskriminues edhe për memorien e brendshme, kështu duke kërkuar memorie të brendshme 4 GB. Në dokumentin PARAMASA-Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station të publikuar nga AK me datë 20.01.2021, është përshkruar tek pozicioni 1. GNSS/GPS, përkatësisht Kontrolleri i antenës GNSS është përshkruar kërkesa “Hapsira memorizuese (ruajtja e të dhënave) jo më e vogël se 4 GB”. Në vendimin e AK-së të datës 28.01.2021 është konstatuar se nuk shkruhet memorie e brendshme rrjedhimisht nënkupton që nuk është obligative që të jetë memorie e brendshme. Andaj, përkundër që specifikimi i hapësirës memorizuese është bërë në kuadër të kontrollerit, sqarimi i dhënë nga AK në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim do ta obligonte AK-në që ta merrte për bazë gjatë vlerësimit rrjedhimisht nuk do të mund të përjashtonte OE që ofrojnë memorie të jashtme. Si përfundim pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 3 : OE ankues pretendon se AK ka vendosur kërkesa sikurse janë formatat DGE, CSV, txt dhe Shapefile format e sipas OE ankues këto kërkesa dalin përtej kërkesave të pajisjeve të kërkuara në këtë aktivitetet të prokurimit. AK në dokumentin PARAMASA-Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station të publikuar me datë 20.01.2021, tek pozicioni 1, përkatësisht tek Softueri i Terrenit ndër të tjera ka vendosur kërkesat: “Te ketë mundësi eksporti ne formatet DGE, CSV, ShapeFile, TXT” dhe “Te ketë mundësi importi e formatet DGE, CSV, ShapeFile, TXT Te ketë mundësi eksporti ne formatet DGE, CSV, ShapeFile, TXT”. Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesave për rishqyrtim të datës 28.01.2021 AK ka konstatuar se arsyeja se pse këto formate janë të nevojshme është për shkak të përdorimit të softuerit CadastralMap dhe të gjitha matjet gjeodezike që pranohen nga tereni janë në formatet që AK ka precizuar tek kërkesat e softuerit në këtë aktivitet të prokurimit dhe se këto formate janë domosdoshmëri. Andaj, sipas shkesave të lëndës fillimisht sqarojmë se tipi i formateve është specifikuar në kuadër të softuerit të pajisjeve matëse. Më tej duke marrë të mirëqena deklaratimet e AK-së konsiderojmë se bazuar në nevojat e deklaruara nga AK pretendimi ankimor është i pabazuar në këtë pikë, pasi që nuk mund të detyrohet AK të heq dorë nga kërkesat që janë nevoja bazike dhe pa të cilat nuk i duhen pajisjet.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 4 : OE pretendojnë se AK ka vepruar në kundërshtim me LPP me rastin e ndarjes së pozicioneve në kërkesën për Autorizim nga prodhuesi. AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka vendosur kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional numër 3 “Autorizim nga prodhuesi apo dileri që dëshmon se kompania është e autorizuar për shitjen e pajisjes GPS-kërkohet origjinal ose kopje e vërtetuar” dhe për këtë kërkesë ka kërkuar që OE të prezantojnë dëshminë dokumentare të formuluar si vijon: “Autorizim nga prodhuesi apo dileri që dëshmon se kompania është e autorizuar për shitjen e pajisjes GPS-kërkohet origjinal ose kopje e vërtetuar” . Në vendimin e AK-së të datës 28.01.2021, AK nuk e ka trajtuar këtë pretendim rrjedhimisht nuk ka dhënë arsyetim apo përgjigje. Në lidhje me këtë pretendim duke qenë që dy pozicionet janë të rëndësishme dhe kanë funksione bashkëvepruese në kuadër të një projekti i rekomandohet AK-së që të kërkojë Autorizim për të dy pajisjet. Andaj pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar për faktin që një pretendim të tillë nuk e ka trajtuar AK në kuadër të kërkesës për rishqyrtim.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 5 : Në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues se AK duhet të informojë se ku gjenden specifikimet teknike dhe të ofrojë informacion për “data sheet”, sqarojmë se sipas LPP-së AK duhet të përpilojnë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë OE-të dhe se është e ndaluar që të hartojnë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë OE. Andaj në këtë kuptim, OE duhet të paraqes pretendime se në cilin rast formulimi i një specifikimi diskriminojnë OE ankues dhe në asnjë rast AK nuk mund të përdorë një broshurë konkrete të një produkti apo një prodhuesi. Andaj pretendimi ankimor është i pabazuar duke marrë parasysh që një kërkesë e tillë e OE ankues nuk bazohet në asnjë dispozitë të legjislacionit për prokurimin publik.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti Shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE-ve: “DWH KOSOVA” Sh.P.K-Prishtinë dhe “DWH ALBANIA” Sh.P.K-Tiranë dhe të aprovohen si pjesërisht të bazuara. Më tej propozohet që të obligohet AK të marrë për bazë sqarimet e dhëna në këtë ekspertizë gjatë ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 18.02.2021 me raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik “DWH Kosova” SH.P.K-Prishtinë, me datë 19.02.2021, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

E nderuar OSHP,

Ne refuzojmë Ekspertit Shqyrtues (ESH) dhe raportin e tij 95/21, date 18.02.2021.

Ne vazhdim ne parashtrojmë para trupit gjykues, argumentet teknike dhe juridike te mos kuptuara dhe anashkaluar nga ESH. Ne refuzojmë bashkimin e dy lendeve ne një te vetme, pasi ankimimi ynë nuk ka te beje me ankimimin e DWH - ALBANIA sh.p.k, qe është subjekt juridik i te drejtës shqiptare, kurse ne jemi subjekt juridik i te drejtës kosovare. Studio e avokatisë, qe këshillon dhe përfaqëson subjektin tone nuk arrin te gjeje bazën ligjore te kësaj shkrirje te dy lendeve te ndryshme dhe dy subjekteve konkurrenente ndërmjet tyre ne një çështje te vetme, duke "krijuar padi kolektive", qe bie ndesh me kodin civil te Republikës se Kosovës. Ne kërkojmë ndarjen e lendeve ne vetvete dhe rishqyrtimin e tyre veç e veç. OSHP nuk ka mundur te kuptoje ankimimin tone, pasi raporti i tij qartëson qe ESH nuk ka edukim gjeodezik, nuk ka edukim juridik dhe si rrjedhoje nuk përmbush "job description" te ESH për çështje gjeodezike. I kujtojmë OSHP, qe behet fjale për blerje Pajisje Gjeodezike për matje ne terren, dhe ESH nuk ka kuptuar sa vijon: 1. AK kërkon formate DËG, TXT, CSV, Shapefile ne Softëare te punës. Softëare pune përmban aplikacionet e matjes (incizim, piketim, distance fikse, sipërfaqe, volum, linje reference etj., etj.) kurse formatet e sipër kërkuar nuk jepen as ne GPS, as ne Kontroller, as ne Softëare pune. Ato janë formate kompjuterike te Atocad, Autodesc, etj. (firme softëerike për kompjuter), kurse AK një subprodukt te Autodesc?!

I kujtojmë OSHP apo AK apo ESH, qe Autodesc nuk është as prodhues i pajisjeve gjeodezike dhe as prodhues i softëare pune te GPS apo Stacioneve totale. Cadastral Map nuk ka te beje fare me formatet e sipër dhënë. Argumenti i AK dhe huazuar nga ESH është fjale boshe, pa baze.

Kjo kërkesë është vene aty për te mundur te shpallin te papërgjegjshëm te gjithë OE, dhe për te parazgjedhur OE Geo TEC, i cili do sajojë ndonjë letër për te manipuluar vendimin.

I vëmë ne dukje OSHP, qe ESH e rrezon këtë pike te ankimimit tone, pa asnjë argument, por kopjen – për medet - tekstin e AK dhe e ri sjell si te vetin.

2. ESH - bazuar ne pretendimin 5 - nuk ka njohuri për LPP04/L-042, Neni 28 pika 1 nënpika (ii), qe e detyron AK te ve ne dispozicion te OE "se ku mund te gjenden specifikimet e kërkuara"

Po kështu ESH nuk e ka parasysh

- a) si përcaktohen nevojat e AK për një produkt te caktuar
- b) si përcaktohet buxheti për blerjen e këtij produkti, dhe
- c) si përcaktohen specifikimet teknike, qe gara te jete e hapur, e drejte, efikase, transparente dhe mos diskriminuese. Sipas ESH mjafton qe AK te këtë nevojë për një pajisje (kërkesa) dhe pastaj mjafton te ëndërrojë, mundësisht me sy mbyllur dhe i shfaqen ne ëndërr buxheti dhe specifikimet teknike. Pastaj po ne ëndërr rregullohen me magjie kërkesat e LPP si drejtësi, mos diskriminim, drejtës, transparenca dhe efikasiteti dhe etj., etj. Dikush duhet ti shpjegojë ESH-së, qe nuk funksionin kështu.

Ne i kërkojmë OSHP

1. te përzgjedh një ESH tjetër, i cili te këtë edukim dhe eksperience gjeodezike, dhe

2. te këtë lexuar LPP04/L-042 dhe nëse është dembel le te lexoje nenin 1,2, 3, 7 dhe 28 dhe mjafton për këtë lenden. Ne i kërkojmë OSHP, qe te beje seance te hapur, edhe ne forme digjitalë online, si edhe po bën gjithë bota. Përshëndetje miqësore.

Operatori ekonomik "DWH Albania" SH.P.K.-Shqipëri, me datë 19.02.2021 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

E nderuar OSHP, ne jemi njohur me raportin e ekspertit (ESH) dhe e refuzojmë atë për arsyet qe vijojnë: Hap paranthese.... Vëmë re qe OSHP ka bashkuar dy lende te ndryshme ankimore ne një te vetme, dhe kjo është një kundërvajtje e ligjore e përsëritur tashme e OSHP. Ky fakt behet edhe me i rende, pasi duke bashkuar dy lende te ndryshme ne një te vetme, OSHP e kthen lenden nga "ankimim (padi) individual" ne "ankimim (padi) kolektive", por padia kolektive nuk është e pranuar ne sistemin e drejtësisë kosovare, e cila mbështet ne drejtësinë evropianë dhe jo ne atë amerikane (ku padia kolektive është e pranuar ne sistem). Por edhe ne sistemin amerikan, padinë kolektive nuk e për zgjedh gjykata, por subjektet paditëse. Pra kjo amulli e OSHP është dhe mbetet unike ne llojin e vet, edhe pse e gabuar. Por ky bashkim antiligjor i lendeve te veçanta ne një te vetme, qe s'ka te beje me ESH, do te mjaftonte qe lënda te rishikohet.mbyll paranthesen. Le ti marrim me radhe bëmat dhe mos bëmat e te ashtuquajturit ESH Pretendimi 1, (sipas ESH) dhe pretendimi ineksistent (sipas DVVHAL) Është i ngritues (shpikur) nga ESH, pasi ne nuk e kemi ankimuar faktin qe AK nuk ka vendosur specifikime teknike për GPS. Ne kemi theksuar qe AK nuk ka vendosur specifikime teknike nominativë për GPS, për te theksuar faktin, qe vendos specifikime për Kontrollerin (pjese ndihmese) dhe me ane te kontrollerit vendos për GPS. Konkluzion 1: ESH ka ngritur një ankese vete dhe pastaj e ka rrezuar po vete! Pretendimi 2 (sipas ESH) dhe pretendimi 1 (sipas DVVHAL). AK vendos te specifikimet teknike te Controller, kërkesën për Memorie 4GB. Pastaj e ri trajton këtë kërkesë ne përgjigje te kërkesës tone për rishqyrtim si "kërkesë për hapësirë teorizuese dhe jo si kërkesë te memories se brendshme". Konkluzion 2: ESH edhe pse na jep te drejte, nuk i bën përshtypje as sjellja dhe as gjuha hileqare e AK, qe vendos ne controller një kërkesë qe - po sipas AK - nuk na qenka për kontrollerin(!). Pretendimi 3 (sipas ESH) apo pretendimi 2 (sipas DWHAL), Kërkesa te huaja për produkte si GPS/Stacion Total, si p.sh. formatet si DĚG, CSV, TXT, Shapefile etj. ESH huazon përgjigjen e AK, qe kjo është nevojë e AK pasi ajo përdor sistemin Cadastral MAP. Por tenderi nuk bazohet ne një këmbë (kërkesën), por ne dy këmbë (edhe ofertën) Kjo kërkesë nuk ka te beje as hiç fare me Softëare Pune, sepse ne softëare pune përmban punët, pra aplikacionet qe ofrohen si p.sh.: Incizim, Piketim Linje reference Plan reference

Lartësi remote Distance fikse etj., etj., Formatet, nisur edhe nga fjala, janë forma te paketimit te te dhënave, te cilat kalohen nga kontrolleri ne kompjuter dhe anasjelltas dhe për ketë arsye jepen ne datasheet te kontrollerit, dhe jo ne datasheet-et e softëare pune. Cadastral Map nuk ka te beje as hicfare me këto formate. Cadastral Map është një harte me objekte te mire definuar si parcela, rruge, kanal, ndërtesë etj. etj. Kjo kërkesë përmbushet

lehtësisht duke kërkuar "mundësinë e map (harte dhe/ose skice) ne kontroller", e cila ofrohet tash e 10 vjet nga kushdo prodhues.

Kurse DËG është nënprodukt i Autodesc, pra është një kopje e Auto ÇAD dhe nuk kuptohet perse kërkohet një kopje dhe jo origjinali, nëse kërkesa do të ishte e mirëqenë!!! DËG nuk ka të bëjë fare me Cadastral map. Pyetje: çfarë GPS po përdor në këtë kohë AK? Konkluzion 3: Duke mos pasur edukim në fushën e gjeodezisë, ESH është gjendur "gafil" dhe për këtë arsye i ka rënë shkurt kësaj pike, duke huazuar përgjigjen e lajthitur të AK dhe duke e bërë atë të veten. Por ligjvënësi nuk ka parapare që ESH, të jetë i huaj dhe paedukuar për fushën në të cilën duhet të japë ekspertizë?! kjo përbën një problem për ligjin dhe gardianin e tij (OSHP). 0

Pretendimi 4: (sipas ESH) dhe pretendimi 3 (sipas DWHAL) Kërkesa për autorizim nga prodhuesi për GPS, dhe mos kërkesa e Autorizimit për Stacion Total, është vënë re nga ESH, por fakti që AK ka bërë rezistencë në përmirësimin e kësaj kërkesë gjysmë, tregon qartë që AK e ka ditur që OE i preferuar do të ofronte GPS nga prodhuesi që përfaqëson dhe ndoshta Stacionin Total nga prodhues anonim.

Konkluzioni 4: Tani AK dhe OE i preferuar, do të duhet të rishikojnë paksa termat e marrëveshjes paraprake që kanë bërë ndërmjet tyre, se me këtë rekomandim do duhet që edhe Stacioni të jetë i mbuluar me MAF, dhe kjo mund të ketë influencë në çmim dhe në raportin çmim/kosto, dhe termat që burojnë nga ky ndryshim?!

Pretendimi 5: (sipas ESH) dhe pretendimi 4 (sipas DWHAL).

Kërkesën tone, që AK të na informojë se ku gjenden specifikimet e kërkuara nga AK, ESH e quan të padrejtte dhe pastaj zhytet në një sallatë fjalësh pa lidhje dhe pa kuptim.

Bile ESH kërkon që OE duhet të thotë (citojmë) "cilin rast formulimi i një specifikimi diskriminon OE" dhe me tej shton "AK nuk mund të përdorë një broshurë konkrete të një produkti apo të një prodhuesi" Parantese e shkurtër— Filozofi Sokrates i ndante njerëzit në të pa nxënë, gjysmë të nxënë dhe të nxënë, ku të parët i klasifikonte si të padëmshëm për shoqërinë, bile zemërgjere, sepse herët ose vonë, por me shumë herët, e pranojnë vetë në mënyrë vullnetare gabimin e tyre, i cili natyrisht buron nga padija, pasi i padituri nuk e din se është i paditur. I paditur kërkon vetëm një kusht, që të pranojë gabimin e vet, që si edhe e thame buron nga padija. Kërkon që ti japësh mundësinë të flasë. Sa me shumë flet, aq më shpejt zbërthehet. mbyllje e parantesës. ESH me "ekspertizën" e tij, vërteton pohimin e Sokrates. Ai në fund pranon që është i paditur në fushën e gjeodezisë, por duke folur gjatë - bile aq gjatë sa shton edhe pikat e ankimit nga 4 në 5 dhe atë që shton vetë e rrezon po vetë - ai pranon që as që e ka lexuar LPP të Republikës së Kosovës.

Diskriminimin e keni në kërkesën për formate, që nuk gjenden në datasheet-et e asnjë prodhuesi, por ESH nuk e ka kuptuar dhe vazhdon dhe pyet?????!!!!

Por mjafton të lexosh "rrumpallen" që ai shkruan në pretendimin 5 për të kuptuar, që ai jo vetëm është pa njohuri në juridiksionin e Republikës së Kosovës, por as e ka lexuar LPP të Republika e Kosovës. ESH kërkesën tone ndaj AK, që "të na informojë se ku gjenden specifikimet teknike të kërkuara nga AK" e quan të gabuar, bile të paligjshme(?!). Por ESH nuk e ka kuptuar që kjo kërkesë nuk është e jona por e LPP04/L-42,

Neni 28, pika 1, nenpika (ii) "AKdo të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike" ESH as që e ka idenë, që LPP vendos në brazde AK, me një sere nenesh dhe pikash, që të sigurojë drejtësi, transparencë, mos diskriminim, integritet, efikasitet etj. etj. Por AK, nëse do të bazohej vetëm në nevojat e veta - si edhe mendon ESH - si do të mund të siguronte drejtësi, transparencë, mos diskriminim, integritet, efikasitet etj. për gjëra që nuk i din dhe nuk i ka marrë parasysh? I bëjmë me dije ESH, procedurën që parasheh ligja për përgatitjen e dosjes së tenderit. Një vit më parë AK identifikon nevojën e vet për produktin që donë të blejë (p.sh. pajisje gjeodezike).

Për këtë i duhet të përcaktojë a) specifikimet teknike, dhe b) buxhetin

AK hulumton tregun e brendshëm - kur tregu i brendshëm është i pamjaftueshëm edhe tregun e jashtëm - duke kërkuar oferta nga ofertues/prodhues të ndryshëm. Në bazë të ofertave të marra përcaktohen 1.

specifikimet teknike, që a) plotësohen nga sa më shumë datasheet-e produktesh, dhe b) që

plotësojnë sa më kënaqshëm nevojat e AK, si dhe 2. Buxhetin e tenderit, bazuar në ofertat ekonomike Pra, ESH, duhet të kuptojë, që vetëm duke u bazuar në dy këmbë KERKESA (nevojat e AK) dhe OFERTEN (e tregut) mund të realizohen kërkesat e LPP. Konkluzion 5: AK duhet të ofrojë jo një datasheet, por disa datasheet-e, në të cilat është bazuar AK për të përzgjedhur specifikimet teknike. Vetëm kjo analizë e tregut bën të mundur që tenderi të jetë i drejtë, transparent, mos diskriminues, efikas, profesional, me integritet etj etj, si edhe e parasheh LPP.

Kërkesë ndaj OSHP. Në i kërkojmë OSHP, që të vendosë një ESH, që ka edukimin e nevojshëm gjeodezik dhe njohuri të mjaftueshme të LPP të Republikës së Kosovës, që të analizojë lenden 98/21. [Raporti i ESH, Kreshnik Spahiu, është një dëshmi dëshpëruese, që ky person është në pamundësi absolute për të kryer këtë detyrë. Ai nuk ka stature për një detyrë të tillë. OSHP duhet të këtë me sensibilitet për limitet e z. Spahiu. Eri Celiku Office Manager

Këshilla juridike: Studio Juridike Haxhia & Hajdari - Këshilla Teknike: Leica Geosystems.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.02.2021, Kryetari i panelit hapi seancën e shqyrtimit kryesorë të ankesës të mbajtur në ZOMM në ora 14:00, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, përfaqësuesit AK-së nuk ka qenë prezent në seancë, ekspertit shqyrtues, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesat e operatorëve ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik "DWH KOSOVA" Sh.P.K - PRISHTINË dhe shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik "DWH ALBANIA" Sh.P.K - TIRANË, sqaron se

pretendimet ankimore të paraqitura nga dy operatorët ekonomik ankues janë të njëjta dhe kanë të bëjnë me dokumentet e tenderit, përkatësisht specifikimet teknike. Të dy operatorët ekonomik ankues, me datë 25.01.2021 kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me pretendime të njëjta ankimore sikurse në këtë ankesë. AK me datë 28.01.2021 ka nxjerr vendim me të cilin refuzon kërkesën për rishqyrtim.

Meqenëse të dy operatorët ekonomik i kanë pretendimet e njëjta si për nga përmbajtja e pikave ankimore, e po ashtu të njëjta edhe për nga pretendimet e shkeljeve ligjore, Paneli Shqyrtues do të jep sqarimet për këto pretendime për të dy operatorët ekonomik.

Në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, janë parashtruar tri ankesa nga OE ankues "DWH KOSOVA" Sh.P.K, e për të cilat Paneli Shqyrtues ka vendosur sipas vendimeve me numër PSh.nr.458/20, PSh.nr.640/20 dhe PSh.nr.1021/20. Po ashtu, OE ankues disa nga pretendimet ankimore të paraqitura në këtë ankesë sikurse janë formatet dhe autorizimi nuk i ka paraqitur si pretendime ankimore në të kaluarën përkundër që këto kërkesa janë vendosur që nga fillimi.

OE ankues pretendojnë se AK ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së duke mos vendosur kërkesa të mjaftueshme për GPS. AK në dosjen e tenderit, respektivisht në para masë ka paraqitur specifikimet teknike, ku ndër të tjera ka përcaktuar "Të përkrah të gjitha sistemet satelitore globale që janë në funksion: GPS, GLONASS, Galileo, Beidou (me të gjithë sinjalet përkatëse për çdo sistem satelitor që prodhuesi ofron)". Paneli Shqyrtues sqaron se Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, përkatësisht Neni 28 përcakton "AK do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. AK është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë OE".

Në lidhje me këtë pretendim sqarojmë se duke qenë që kërkesat nuk janë përjashtuese pretendimi ankimor është i pabazuar.

Operatorët ekonomik ankues po ashtu pretendojnë se AK ka vendosur specifikime diskriminuese edhe për memorien e brendshme, kështu duke kërkuar memorie të brendshme 4 GB.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dokumentin PARAMASA-Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station të publikuar nga AK me datë 20.01.2021, është përshkruar tek pozicioni 1. GNSS/GPS, përkatësisht Kontrolleri i antenës GNSS është përshkruar kërkesa "Hapsira memorizuse (ruajtja e të dhënave) jo më e vogël se 4 GB". Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në vendimin e AK-së të datës 28.01.2021 është konstatuar se nuk shkruhet memorie e brendshme rrjedhimisht nënkupton që

nuk është obligative që të jetë memorie e brendshme. Andaj, përkundër që specifikimi i hapësirës memorizuese është bërë në kuadër të kontrollerit, sqarimi i dhënë nga AK në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim do ta obligonte AK-në që ta merrte për bazë gjatë vlerësimit rrjedhimisht nuk do të mund të përjashtonte OE që ofrojnë memorie të jashtme. Si përfundim pretendimi ankimor në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Operatorët ekonomik ankues pretendojnë se AK ka vendosur kërkesa sikurse janë formatat DGE, CSV, txt dhe Shapefile, formate sipas OE ankues këto kërkesa dalin përtej kërkesave të pajisjeve të kërkuara në këtë aktivitetet të prokurimit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK në dokumentin PARAMASA-Furnizim me pajisje të instrumentit GPS dhe Total Station të publikuar me datë 20.01.2021, tek pozicioni 1, përkatësisht tek Softueri i Terrenit ndër të tjera ka vendosur kërkesat: “Te ketë mundësi eksporti ne formatet DGE, CSV, ShapeFile, TXT” dhe “Te ketë mundësi importi e formatet DGE, CSV, ShapeFile, TXT Te ketë mundësi eksporti ne formatet DGE, CSV, ShapeFile, TXT ”. Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesave për rishqyrtim të datës 28.01.2021 AK ka konstatuar se arsyeja se pse këto formate janë të nevojshme është për shkak të përdorimit të softuerit CadastralMap dhe të gjitha matjet gjeodezike që pranohen nga terreni janë në formatet që AK ka precizuar tek kërkesat e softuerit në këtë aktivitet të prokurimit dhe se këto formate janë domosdoshmëri. Andaj, sipas shkresave të lëndës, tipi i formateve është specifikuar në kuadër të softuerit të pajisjeve matëse. Më tej duke marrë të mirëqena deklaratimet e AK-së, konsiderojmë se bazuar në nevojat e deklaruara nga AK, pretendimi ankimor është i pa bazuar në këtë pikë, pasi që nuk mund të detyrohet AK të heq dorë nga kërkesat që janë nevoja bazike dhe pa të cilat nuk i duhen pajisjet.

OE pretendojnë se AK ka vepruar në kundërshtim me LPP me rastin e ndarjes së pozicioneve në kërkesën për Autorizim nga prodhuesi.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka vendosur kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional numër 3 “Autorizim nga prodhuesi apo dileri që dëshmon se kompania është e autorizuar për shitjen e pajisjes GPS-kërkohet origjinal ose kopje e vërtetuar” dhe për këtë kërkesë ka kërkuar që OE të prezantojnë dëshminë dokumentare të formuluar si vijon: “Autorizim nga prodhuesi apo dileri që dëshmon se kompania është e autorizuar për shitjen e pajisjes GPS-kërkohet origjinal ose kopje e vërtetuar”. Në vendimin e AK-së të datës 28.01.2021, AK nuk e ka trajtuar këtë pretendim rrjedhimisht nuk ka dhënë arsyetim apo përgjigje. Në lidhje me këtë pretendim duke qenë që dy pozicionet janë të rëndësishme dhe kanë funksione bashkëvepruese në kuadër të një projekti, i rekomandohet AK-së që të kërkojë Autorizim për të dy pajisjet. Andaj pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar për faktin që një pretendim të tillë nuk e ka trajtuar AK në kuadër të kërkesës për rishqyrtim.

Në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues se AK duhet të informojë se ku gjenden specifikimet teknike dhe të ofrojë informacion për "data sheet".

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se sipas LPP-së, AK duhet të përpilojnë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë OE-të dhe se është e ndaluar që të hartojnë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë OE. Andaj në këtë kuptim, OE duhet të paraqes pretendime se në cilin rast formulimi i një specifikimi diskriminojnë OE ankues dhe në asnjë rast AK nuk mund të përdorë një broshurë konkrete të një produkti apo një prodhuesi. Andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar duke marrë parasysh që një kërkesë e tillë e OE ankues nuk bazohet në asnjë dispozitë të legjislacionit për prokurimin publik.

Sa i përket parashtrës së operatorit ekonomik "DWH Kosova" SH.P.K-Prishtinë të datës 19.02.2021, ku në këtë parashtrësë e refuzon bashkimin e dy lëndëve në një të vetme me arsyetimin se ankesa nuk ka të bëjë me ankesën e DWH - ALBANIA sh.p.k, që është subjekt juridik i të drejtës shqiptare, kurse ne jemi subjekt juridik i të drejtës kosovare. Më tej, në këtë parashtrësë potencon se studio e avokatisë, që këshillon dhe përfaqëson subjektin tonë nuk arrin të gjejë bazën ligjore të kësaj shkrirje të dy lëndëve të ndryshme dhe dy subjekteve konkurrencte ndërmjet tyre në një çështje të vetme, duke "krijuar padi kolektive", që bie ndesh me kodin civil të Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues fillimisht i sqaron operatorit ekonomik ankues "DWH Kosova", se në Republikën e Kosovës nuk ekziston Kod Civil ashtu siç pretendon OE ankues. Në lidhje me pretendimin se studio ligjore e OE ankues nuk arrin të gjejë bazën ligjore ku potencon: *"të kësaj shkrirje të dy lëndëve të ndryshme dhe dy subjekteve konkurrencte ndërmjet tyre në një çështje të vetme"*, Paneli Shqyrtues i sqaron OE ankues dhe studios ligjore të OE ankues, se bashkimi i procedurës bëhet në bazë të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më saktë në bazë të nenit 84 (Bashkimi i çështjeve administrative në një procedurë), ku në këtë nen është përcaktuar:

1. Organi publik kompetent mund të bashkojë disa procedura administrative në një të vetme, nëse të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira bazohen në një gjendje faktike dhe bazë juridike të njëjtë apo të ngjashme.
2. Bashkimi i procedurave nuk kufizon të drejtën e palëve për të paraqitur kërkesa apo pretendime të ndryshme.

Meqenëse bëhet fjalë për të njëjtin aktivitet të prokurimit dhe pretendime të njëjta ankimore, Paneli Shqyrtues me qëllim të efikasitetit të procedurës administrative, në bazë të nenit 10 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e bënë bashkimin e disa procedurave administrative në një të vetme, ku par. 2 i nenit 10 të këtij ligji ka përcaktuar:

2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative.

Sa i përket pretendimeve tjera në parashtrësat e dy operatorëve ekonomik, duke cenuar profesionalizimin, integritetin, dinjitetin e çdo gjë tjetër të ekspertit shqyrtues, Paneli Shqyrtues i sqaron operatorit ekonomik se për çdo pakënaqësi në procedurë, çoftë me mendimin e ekspertit, çoftë me konstatimet e Panelit Shqyrtues, mundet që të parashtroj ankesë pranë Gjykatës kompetente. Në të kundërtën, Paneli Shqyrtues i tërheq vërejtjen të dy operatorëve ekonomik që të parashtrojnë ankesën konform dispozitave të LPP-së dhe të mos merren me ofendime duke kaluar në rrafshin personal sepse nuk është në kompetencë të operatorëve ekonomik që ti vlerësojnë aftësitë e ekspertëve shqyrtues. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues i sqaron të dy operatorëve ekonomik se nuk është hera e parë që në ankesat e tyre kanë qasje agresive kundrejt ekspertëve shqyrtues vetëm pse nuk pajtohen me mendimin e ekspertëve. Në të kundërtën, dy operatorët ekonomik e obligojnë Panelin Shqyrtues që të ndërmerr veprime ligjore kundrejt tyre.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues duhet ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje të tenderit, duke marrë për bazë sqarimet e ekspertit shqyrtues dhe konstatimet e Panelit Shqyrtues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Gjakovë";
- 1x1 OE "DWH Kosova" SH.P.K-Prishtinë;
- 1x1 OE "DWH Albania" SH.P.K.-Tiranë-Shqipëri;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.